REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
Gjykata Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court
Njesia org / Org. jed / Org. Unit DRLSA
Nr. Prot / Br. Prot / Prot. No 1169
Nr. i faqeve / Br. stranica / No. pages
Data / Datum / Date 30.07.2018

Pranuar / Primljeno
30 JUL 2018
Në ora : časova

# FORMULAR I KËRKESËS

për

parashtrimin e kërkesës, në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të neneve: 46, 47, 48, 49 dhe 50, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

në

Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës

# I. PALA/PALËT QË PARASHTROJNË KËRKESË

Ju lutemi, shkruani të dhënat tuaja personale, si dhe ato të Përfaqësuesit tuaj, nëse keni:

1. Mbiemri: Morina
2. Emri: Blerta
3. Gjinia:
   - ☐ Mashkullore
   - ■ Femërore
4. Profesioni: ..........
5. Data e lindjes: [redacted]
6. Vendi i lindjes: [redacted]
7. Adresa e përhershme:
   [redacted]
8. Nr. tel.: [redacted]
9. E-mail: blert@cel-ks.org
10. Adresa aktuale (nëse dallon nga pika 7.):
    Prishtinë
11. Emri i Përfaqësuesit, nëse keni:
    Avokatja Rina Kika
12. Profesioni i Përfaqësuesit (nëse Përfaqësuesi është avokat, shkruani Shoqatën e Avokatëve, anëtar i së cilës është):
    Avokate Rina Kika nga Kika & Associates SH.P.K.
13. Adresa e Përfaqësuesit:
    Rr. Edith Durham B1 Nr.1/11, 10000 Prishtinë, Kosovë
14. Nr. tel.: 049 355 722
15. Nr. fax: ..........
16. E-mail: rina@kika-associates.com
17. Emri i palës/palëve të kundërshtuara, nëse dihet:
    Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Punëve të Brendshme
18. Adresa e palës/palëve të kundërshtuara, nëse dihet:
    Rr. Luan Haradinaj p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë
19. Nr. tel.: 038/200 19 186
20. Nr. fax.: ..........
21. E-mail: ..........

## II. PËRSHKRIMI I PËRMBLEDHUR I FAKTEVE

Ju lutemi, jepni hollësi të qarta dhe koncize për aktet dhe/ose vendimet e autoriteteve publike si, për shembull: autoritetet administrative, gjyqësore dhe të tjera, ndaj të cilave ankoheni. Përshkruani faktet sipas renditjes kronologjike. Nëse ankesat tuaja kanë të bëjnë me një numër çështjesh (për shembull, disa procedura gjyqësore), ju lutemi ta trajtoni secilën çështje ndaras.

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

## III. ARSYETIMI I KËRKESËS DHE SHKELJET E PRETENDUARA TË KUSHTETUTËS

Ju lutemi, shpjegoni se cilat janë ankesat tuaja sipas Kushtetutës. Saktësoni nenin e Kushtetutës që është shkelur, e veçanërisht saktësoni pse mendoni që akti i autoritetit publik ka shkelur të drejtat dhe liritë tuaja të garantuara me Kushtetutë.

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

## IV. SHTERIMI I MJETEVE JURIDIKE

Ju lutemi, keni parasysh se duhet të vërtetoni që keni shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjeve në fuqi. Kjo do të thotë se, në ankesat tuaja ndaj vendimeve të kundërshtuara të autoriteteve përkatëse dhe të gjykatave kompetente (duke përfshirë edhe ankesat në shkallën më të lartë), ju duhet të keni ngritur të njëjtat çështje kushtetuese (së paku të nënkuptuara ose në përmbajtje) me ato që po i ngrini tash para Gjykatës Kushtetuese.

22. Vendimi i fundit për rastin tuaj

Autoriteti apo gjykata më e lartë tek e cila keni parashtruar ankesë dhe që ka marrë vendimin përfundimtar:

Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

| Vendimi Nr. | Data e miratimit | Data kur e keni pranuar vendimin |
|---|---|---|
| 64/04 | 13.06.2018 | 26.06.2018 |

23. Vendimet e tjera përkatëse

Shënoni, sipas renditjes kronologjike, autoritetin dhe/ose gjykatën që ka marrë vendim për rastin tuaj, si dhe shkruani numrat dhe datat e këtyre vendimeve.

| | Autoriteti/Gjykata që ka marrë vendim | Nr. i vendimit | Data e miratimit |
|---|---|---|---|
| 1. | Zyra e Gjendjes Civile Gjakovë | 02-201-02-8319 | 26.04.2018 |
| 2. | Agjencia e Regjistrimit Civil | 64/04 | 13.06.2018 |
| 3. | | | |
| 4. | | | |
| 5. | | | |
| 6. | | | |
| 7. | | | |
| 8. | | | |
| 9. | | | |
| 10. | | | |

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

Bashkëngjitni kopjet e gjitha dokumenteve (pra, jo origjinalet), sepse ato nuk do t'ju kthehen.

A ka, ose a ka pasur ndonjë mundësi ankese apo ndonjë mjet tjetër juridik në dispozicion, të cilin nuk e keni shfrytëzuar për një arsye të caktuar? Nëse po, shpjegoni pse nuk e keni shfrytëzuar:

Kundër Vendimit të Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, është ushtruar ankesë në Agjencinë e Regjistrimit Civile ("ARC"). ARC ka nxjerrë vendim refuzues për ankesën dhe ka vërtetuar vendimin e Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë. Duke pasë parasyshë afatin për paraqitjen e padisë së konfliktit administrtiv, pa e paragjykuar vendimin Gjykatës Kushtetuese për pranim të shqyrtimit të kërkesës, ne kemi paraqitur edhe padinë për konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

Në rastin konkret, konsiderojmë se paraqitja e padisë për konfliktin administrativ është mjet i papërshtatshëm dhe jo-efektiv juridik pasi që janë plotësuar kushtet dhe rrethanat që Parashtruesi të lirohet nga detyrimi i shterjes së mjeteve juridike ashtu siç spjegohet në seksionin "Shterimi i Mjeteve" të Kërkesës së bashkëngjitur.

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

## V. DOKUMENTACIONI DHE INFORMATAT PËRCJELLËSE

Ju lutemi, shënoni të gjitha dokumentet dhe informatat e tjera në mbështetje të kërkesës. Bashkëngjitni kopjet e të gjitha dokumenteve (pra, jo origjinalet), sepse ato nuk do t'ju kthehen.

| | |
|---|---|
| 1. | Rekomandimi i Psikologut dhe Psikoterapeutit, 27.12.2017 |
| 2. | Raporti Mjeksor, Sistina - Shkup, 06.06.2018 |
| 3. | Kërkesa për Ndërrimin e Emrit dhe të Shënuesit të Gjinisë, 04.04.2018 |
| 4. | Vendimi refuzues i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë, 26.04.2018 |
| 5. | Ankesa ndaj Vendimit, 24.06.2018 |
| 6. | Vendimi refuzues i Agjencisë për Regjistrim Civil, 13.06.2018 |
| 7. | Padia për konfliktin administrativ, 24.07.2018 |
| 8. | |
| 9. | |
| 10. | |

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

## VI. PASQYRA E ZGJIDHJES SË KËRKUAR

Ju lutemi, shkruani shkurt se çfarë dëshironi të arrini me kërkesën tuaj:

Kërkojmë nga Gjykata Kushtetuese që pas shqyrtimit të të thënave të mësipërme dhe provave të bashëngjitura të nxjerrë Aktgjykim dhe vendosë:
I. Të shpallë kërkesën për shqyrtimin e kushtetutshmërisë si të pranueshme;
II. Të gjejë se ka pasur shkelje të së drejtës së privatësisë të paraparë me nenin 36 të Kushtetutës;
III. Të gjejë se ka pasur shkelje të dinjitetit të Parashtruesit sipas nenit 23 të Kushtetutës;
IV. Të gjejë se ka pasur shkelje të të drejtës në mbrojtje të barabartë dhe liri nga diskriminimi sipas nenit 24 të Kushtetutës;
V. Të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil të pranojë si të bazuar kërkesën për ndërrimin e emrit nga "Blerta" në "Blert" dhe të shënuesit të gjinisë nga "F" në "M" në regjistrin qëndror të gjendjes civile për Parashtruesin.
VI. Të urdhërojë Agjencinë e Regjistrimit Civil t'ia kompensojë Parashtruesit dëmin jomaterial në vlerë prej 5'000 euro, si dhe shpenzimet procedurale dhe shpenzimet e avokates.

*(Nëse keni nevojë për më shumë hapësirë, vazhdoni në një faqe të ndarë)*

## VII. GJUHA ZYRTARE

Cila gjuhë zyrtare do të donit të përdorej në komunikim me ju?

☑ Gjuha shqipe
☐ Gjuha serbe

## VIII. KONFIDENCIALITETI

Në përgjithësi, procedura në Gjykatë është publike, derisa identiteti i palëve bëhet publik. Megjithatë, për arsye të veçanta, mund të kërkoni që identiteti juaj të mos zbulohet publikisht. Në këtë rast, duhet ta theksoni këtë, bashkë me arsyet e veçanta për këtë kërkesë. Gjykata është ajo që do të vlerësojë nëse duhet të miratohet kërkesa juaj.

Megjithatë, duhet të jeni të vetëdijshëm që identiteti juaj duhet zbuluar palës së kundërshtuar.

Pra, nëse dëshironi që identiteti juaj të zbulohet ose jo gjatë procedurës në Gjykatën Kushtetuese, ju lutemi, vini shenjë në kutinë përkatëse.

☑ Të zbulohet ☐ Të mos zbulohet

Nëse keni kërkuar që identiteti juaj të mos zbulohet, theksoni arsyet e veçanta:

....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................
....................................................................................................................................

## IX. DEKLARIMI DHE NËNSHKRIMI

*Deklaroj se informatat që kam dhënë në këtë formular kërkese janë të sakta, sipas njohurisë sime dhe besimit tim.*

SH.P.K.
Kika & Associates
Prishtinë

Avokate - Attorney at law
RINA KIKA
Prishtinë

(Nënshkrimi i palës/palëve që parashtrojnë kërkesë, apo përfaqësuesit),

Prishtinë
(Vendi)

30.07.2018
(Data)

Vërejtje: Nëse deklarata është nënshkruar nga përfaqësuesi, formularin e kërkesës duhet ta shoqërojë edhe një dokument i plotë i autorizimit, i nënshkruar plotfuqishëm nga pala/palët që parashtrojnë kërkesë, si dhe nga përfaqësuesi. Një mostër e dokumentit të autorizimit është bashkëngjitur te "Udhëzime ndihmëse për palë/palët në parashtrim të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës", që mund të gjendet në Sekretariatin e Gjykatës, si dhe në faqen e internetit të Gjykatës (www.gjk-ks.org). Kur jeni të përfaqësuar, Gjykata nuk mban korrespondencë me juve, por vetëm me përfaqësuesin tuaj.

Përfaqësuesi i një subjekti juridik (kompani, shoqatë, etj.), apo i një grupi individësh, duhet të ofrojë dëshmi të autorizimit të tij nga personi kompetent i subjektit juridik, apo nga grupi i individëve, për ta përfaqësuar atë në procedurën e Gjykatës Kushtetuese.

**Ky formular i kërkesës duhet dorëzuar në këtë adresë:**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës

Sekretari i Përgjithshëm

Rr. "Perandori Justinian", Nr. 44
Republika e Kosovës
10000 Prishtinë